

AFATET DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME NË FUSHËN E TI-së NË RAIFFEISEN BANK KOSOVO J.S.C (në tekstin e mëposhtëm AKP-ët)

1. PËRKUFIZIME

Kontratë do të thotë marrëveshje përkatëse me shkrim për furnizim të shërbimet si dhe çdo urdhër blerje, marrëveshje për blerje, fushëveprim të punës, deklaratë të punës, etj. në lidhje me kontratën e miratuar ndërmjet klientit dhe furnizuesit dhe përmbajtja e përshkrimit të shërbimeve dhe dispozitave të tjera përkatëse.

Klient do të thotë furnizuesi nga i cili Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C blen shërbime.

Me shkrim do të thotë të jetë në formë të shkruar me anë të letrës, faksit ose kopje në formatin pdf të bashkëlidhur në email dhe të nënshkruar nga furnizuesi dhe/ose përfaqësuesit e autorizuar në mënyrë të rregullt të klientit (siç aplikohet).

Palët do të thotë furnizuesi dhe klienti bashkërisht dhe "Pala" do të thotë njëri nga ta.

RBKO do të thotë Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C me adresë në Rr. Robert Doll No.99, 10 000.

Shërbimet do të thotë shërbimet e integritit në sistem në fushën e TI-së të ofruara nga furnizuesi për klientin, duke përfshirë rezultatin/produktin e shërbimeve të kryera.

Furnizues do të thotë subjekti që ofron shërbime klientit.

AKP do të thotë afatet dhe kushtet e përgjithshme për shërbime në fushën e TI-së në Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

2. OFERTA dhe FUSHËVEPRIMI

2.1 Këto AKP-ë aplikohen për të gjitha blerjet e shërbimeve nga ana e klientit prej furnizuesit. Në rast se shërbimet konsiderohen si shërbime të jashtë kontraktuara atehere kushtet që dalin nga Udhezuesi i Autoritetit Bankar European per Shërbime të jashtëkontraktuara do të aplikohen.

2.2 Kontrata përmban dispozita të tjera në lidhje me përshkrimin dhe përmbajtjen e shërbimeve, siç janë: afate kohore dhe afatet e fundit, çmimi i blerjes së shërbimeve, procedurat e pranimit, veçanërisht detyrimet e palëve dhe çdo dispozitë tjetër e nevojshme.

2.3 Këto AKP-ë të jenë pjesë e pandashme e kontratës. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet AKP-ve dhe kontratës, mbizotërojnë dispozitat përkatëse të kontratës.

2.4 Çdo ndryshim i qëllimshëm i kontratës (edhe në qoftë se bëhet përmes telefonit ose gojarisht) do të jetë detyruese për palët vetëm atëherë kur palët të pajtohen me shkrim. Megjithatë, çdo urdhër individual në lidhje me kontratën mund të bëhet nga klienti edhe në formë elektronike. Furnizuesi është i detyruar ta kontrollojë emailin përkatës çdo ditë dhe ta konfirmojë urdhrin e tillë të klientit sa më shpejt të jetë e mundur. Në çdo rast, urdhri elektronik i klientit konsiderohet i pranuar nga furnizuesi nëse furnizuesi nuk e kundërshton urdhrin e tillë elektronik të klientit brenda 2 ditëve pasi ai të jetë dërguar nga klienti.

2.5 Furnizuesi nuk ia cakton ose transferon të drejtën dhe detyrimet e tij sipas kontratës ndonjë personi tjetër ose nën-kontraktori pa pëlqimin e shprehur të dhënë nga Banka.

2.6 Furnizuesi nuk ka të drejtë të punësojë palë të treta për zbatimin e kontratës, përveç nëse para miratohet nga klienti me shkrim (miratimi i tillë nuk duhet të refuzohet pa arsye). Furnizuesi merr përgjegjësinë e plotë për ato palë të treta dhe punësimi i atyre palëve të treta nuk e liron furnizuesin nga obligimet e veta në raport me kontratën.

2.7 Shërbimet e ofrohen me çmim fiks. Në rast se palët bien dakord që shërbimet të aplikohen në bazë të orëve të punës dhe shpenzimeve të bëra (marrëveshje e bazuar në kohë dhe material), furnizuesi duhet të ofrojë përlllogaritje të tarifave për shërbimet dhe shumë maksimale për shërbimet e tilla. Shuma e tillë maksimale nuk duhet të tejkalohet nga furnizuesi. Nuk ka rritje të çmimit gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes. Kufizimi i tillë nuk aplikohet në rast se çmimi e përfshinë TVSH-në dhe ekziston një ndryshim legjislativ në përqindjen në fuqi të TVSH-së.

3. PERFORMANCA

3.1 Shërbimet kryhen në vendin, datën dhe kohën e pajuar nga palët në kontratë.

3.2 Vendi i kryerjes është vendi ku shërbimet duhet të kryhen në përputhje me kontratën.

3.3 Furnizuesi është përgjegjës për zbatimin e projektit dhe dokumentacionin e projektit dhe i ofron klientit raporte përkatëse për statusin rregullisht dhe me kërkesë.

3.4 Në rast se furnizuesi nuk është në gjendje t'i kryejë shërbimet në vendin, datën dhe kohën pajuar nga palët në kontratë për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të furnizuesit (p.sh. forca madhore, greva, fatkeqësitë natyrore, aktet e luftës), klienti mund - në diskrecionin e tij të vetëm - të pajtohet për zgjatje të kohës për kryerje. Në rast se furnizuesi nuk pajtohet me zgjatje të tillë, klienti ka të drejtë ta anulojë kontratën pa u përballur me ndonjë kërkesë nga furnizuesi.

3.5 Sa i përket ndonjë vonese në afatet e pajtuara për kryerje të shërbimeve, klienti rezervon të drejtën të aplikojë tarifë dënimi me shumën që përcaktohet në kontratë. Në rast se vonesa kalon disa ditë (të përcaktohet në kontratë), Banka ka të drejtë ta anulojë këtë marrëveshje menjëherë. Në këtë rast, furnizuesi detyrohet të paguajë 30% të shumës së pajtuar me marrëveshje. Furnizuesi nuk ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për dëmet.

3.6 E drejta e Bankës për të kërkuar dëmshpërblim shtesë mbetet e paprekur nga dënimi kontratual, si dhe, në veçanti, por pa u kufizuar në, përfshinë çdo kosto të shkaktuar nga Banka për prokurimin e zëvendësimit të shërbimeve nga një tjetër furnizues.

3.7 Furnizuesi mund të devijojë nga afatet dhe kushtet e pajtuara për dispozitat e shërbimeve vetëm me kusht që paraprakisht klienti të jetë informuar siç duhet për devijimin e synuar dhe klienti të ketë dhënë pëlqimin e tij me shkrim për këtë qëllim. Dispozitat më specifike në TPK-ët mbesin të paprekura.

3.8 Furnizuesi i ofron klientit fleta të hollësishme të punës për shërbimet e kryera, duke përfshirë informacione të detajuara mbi shërbimet e kryera, kohët e punës të personave që kryejnë shërbime të tilla

dhe çdo kosto dhe shpenzime që lidhen me to. Fletët e tilla të punës të ofruara për klientin së bashku me faturë ose çdo muaj (çfarëdo që ndodhë më herët).

3.9 Furnizuesi i ofron klientit çdo dokumentacion të nevojshëm në lidhje me shërbimet, siç janë ato administrative, licencat, manualët e përdoruesit dhe instalimit pa pagesë. Për aq sa është e mundshme në mënyrë të arsyeshme dokumentacioni jepet në gjuhën e vendit të klientit dhe në anglisht.

3.10 Pas përfundimit të shërbimeve të pajtuara fillon procedura e pranimit përfundimtar.

3.11 Pasi pranimi përfundimtar (me tej si "**Vendimi i pranimit përfundimtar**") të jetë bërë nga përfaqësuesi i klientit ose komiteti drejtues (nëse është krijuar) në bazë të procedurës së pranimit të pajtuar, shërbimet e pranimit funksionalizohen.

3.12 Rreziku i shërbimeve është dhe i mbetet furnizuesit derisa Vendimi i pranimit përfundimtar pas së cilit rreziku i bartet klientit.

3.13 Mbështetja pas zbatimit pajtohet me kontratë.

4. DREJTIMI DHE ZBATIMI I PROJEKTIT

4.1 Secila palë cakton një ose më shumë përfaqësues përgjegjës për drejtues, menaxhim dhe mbikëqyrje të ekipit të projektit të palës së tillë.

4.2 Palët mund të bien dakord të caktojnë një komitet drejtues. Komiteti i tillë drejtues në veçanti është përgjegjës për mbikëqyrje të progresit të projektit dhe për vendime mbi çështje që i parashtrihen atij nga përfaqësuesit.

4.3 Në kontratë palët bien dakord më tej për çështje që i drejtohen përfaqësuesve dhe komitetit drejtues dhe për procedurën përkatëse të përshkallëzimit. Në rast se kontrata nuk përmban dispozita të tilla specifike, çdo çështje që nuk mund të zgjidhet nga përfaqësuesit e ekipeve të projektit të palëve brenda 8 ditësh i referohet komitetit drejtues. Gjithashtu, çështjet që kanë të bëjnë me kosto dhe afate të fundit i referohen komitetit drejtues (nëse është krijuar).

4.4 Në përgjithësi, të gjitha vendimet e përfaqësuesve dhe të komitetit drejtues bëhen me shkrim dhe nëse ndonjë vendim nuk merret me shkrim, ai nuk është detyrues për palët.

4.5 Takim i komitetit drejtues mblidhet me kërkesën cilitdo përfaqësues. Palët edhe mund të bien dakord se komiteti drejtues të mblidhet periodikisht.

4.6 Gjatë asaj kohe çdo çështje është në pritje para se përfaqësuesve ose komitetit drejtues kryerja e shërbimeve vazhdon përveç nëse klienti e njofton furnizuesin ndryshe.

5. KËRKESA PËR NDRYSHIM

5.1 Gjatë zbatimit të projektit të dyja palët mund të kërkojë që përmbajtja e kontratës të ndryshohet ose të bëhen shtesa. Rrethanat e tilla mund, në mënyrë të veçantë, të bazohen mbi ndryshime të nevojshme ose të duhura për arritjen e objektivit të dakorduar ose t'i përshtatet kontrata mjedisit të ndryshuar.

5.2 Ndryshimet e kontratës kërkojnë marrëveshje me shkrim të të dyja palëve për të hyrë në fuqi dhe po ashtu përmbajnë ndryshimin përkatës, arsyen për ndryshim dhe ndikimin e pritshëm të ndryshimit në projekt.

5.3 Kërkesat për ndryshime ose shtesa të bëra nga klienti u paraqiten me shkrim përfaqësuesve të furnizuesit.

5.4 Në qoftë se, sipas mendimit të furnizuesit, ndryshimet ose shtesat e kërkuara nga klienti mund të ketë efekt mbi afatet e fundit, objektivat ose kostot, të tillat i paraqiten klientit brenda 5 ditëve të punës në bazë të indikacioneve të detajuara dhe të detyrueshme të efektit mbi afatet e fundit, objektivat ose kostot, së bashku me një ofertë të detyrueshme të arsyeshme. Nëse klienti pajtohet me ofertën e furnizuesit, ajo i paraqitet furnizuesit me shkrim brenda 14 ditëve të punës; përndryshe oferta e furnizuesit konsiderohet e refuzuar. Kërkesat për ndryshime të vogla të klientit kryhen nga furnizuesi pa pagesë.

5.5 Gjithashtu, furnizuesi ka të drejtë të sugjerojë ndryshime të drejtuara për përfaqësuesit e klientit. Sugjerimet për ndryshime përmbajnë, në mënyrë të detyrueshme, informacion mbi ndonjë efekte në afatet e fundit, objektivat ose kostot. Nëse përfaqësuesi i klientit nuk miraton me shkrim sugjerimin e tillë për ndryshim brenda 14 ditëve të punës, sugjerimet e tilla konsiderohen të refuzuara.

5.6 Kërkesa për ndryshim nuk zbatohet derisa një marrëveshje përkatëse e nënshkruar nga të dyja palët të hyjë në fuqi.

6. PAGESA

6.1 Pasi shërbimet të kryhen në pajtueshmëri me kontratën, furnizuesi e lëshon faturën.

6.2 Fatura duhet të përmbajë të paktën informatat e mëposhtme:

- Emrin dhe adresën e furnizuesit dhe klientit
- Shumën dhe përshkrimin e shërbimeve
- Çmimin e blerjes
- Numrin e urdhrimit për blerje
- Afatet e pagesës dhe datën e pagesës
- Numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin tatimor të furnizuesi dhe klientit
- TVSh-n (nëse ka)
- Datën dhe nënshkrimin e furnizuesit

6.3. Në rast se fatura nuk i përmban të gjitha këto informata, nuk kërkohet nga klienti që ta pranojë faturën, dhe koha e pagesës nuk fillon para se klienti të ofrojë faturë që i përmban të gjithë këto informata.

6.4. Përveç nëse pajtohen ndryshe, çmimi i blerjes i pajtuar për shërbimet tashmë i përfshinë çdo TVSH ose tatim tjetër të cilave u nënshtrohet furnizuesi (taksat, detyrimet ose pagesat e tjera), si dhe ndonjë kosto tjetër për pagesë në lidhje me shërbimet (p.sh. shpenzimet e udhëtimit, koha e udhëtimit, shpenzimet nga xhepi, akomodimi, etj.).

6.5. Furnizuesi i ofron klientit të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që të shmangët çdo tatim të dyfishtë. Në rast se furnizuesi nuk e bën këtë, të gjitha këto shpenzime do të mbulohen nga furnizuesi.

6.6. Të gjitha pagesat bëhen përmes transferit bankar vetëm në llogari të furnizuesit të mbajtur në një bankë me reputacion në vendin e furnizuesit. Secila palë mbulon shpenzimet e veta në lidhje me transferin e tillë.

6.7. All payments shall be made by bank transfer only to the account of the Supplier held with a bank in the country of the Supplier. Each Party shall bear its own costs in connection with such transfer

6.8. Çmimi i blerjes shprehet në euro. Në raste të veçanta, klienti dhe furnizuesi mund të bien dakord me shkrim se çmimi i blerjes të shprehet në valutën vendore të furnizuesit ose që çmimi i blerjes i cili shprehet në euro të paguhet në valutën vendore të furnizuesit. Në rastin e fundit, palët bien dakord për një normë të këmbimit mes euros dhe valutës vendore përkatëse para nënshkrimit të kontratës.

7. TË DREJTAT E PRONËSISË DHE SHKELJA

7.1. Klienti pranon se ai nuk zotëron ose nuk do të zotërojë asnjë të drejtë të pronësisë intelektuale në shërbimet. Megjithatë, çdo zhvillim i bërë nga furnizuesi me kërkesë të klientit bëhet për të mirën e klientit. Klienti ka të drejtë të përdorë të drejtën e pronësisë intelektuale ose licencat e furnizuesit në lidhje me shërbimet.

7.2. Furnizuesi e dëmshpërblen klientin plotësisht dhe në mënyrë efektive kundër të gjitha dhe çdo procedure, veprimi, pretendimi, kërkesë, kostojë, shpenzimi (duke përfshirë por jo e kufizuar në kostot dhe pagesat ligjore në baza të avokatit dhe klientit) humbjeje dhe dëmtimi që rrjedhin nga ose shkaktohen për shkak të ndonjë shkeljeje ose shkelje të pretenduar të të drejtave të pronësisë intelektuale të çdo personi për shkak të posedimit ose shfrytëzimit nga klienti të shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre, me kusht që klienti ta njoftojë furnizuesin me shkrim për çdo pretendim të tillë të shkeljes së bërë ndaj klientit.

7.3. Klienti, me kërkesë dhe shpenzime të furnizuesit, i lejon furnizuesit të kryejë dhe/ose zgjidhë të gjitha negociatat dhe procedurat gjyqësore që rezultojnë nga pretendimet e tilla dhe shpenzimet e bëra ose të rikuperuara në negociata dhe procedurat e tilla gjyqësore janë për llogari të furnizuesit. Klienti, me kërkesë të furnizuesit, i jep furnizuesit ndihmë të tillë të arsyeshme pasi që furnizuesi mund të kërkojë në lidhje me negociatat dhe procedurat e tilla gjyqësore në lidhje me furnizuesin rimbursimin të të gjitha kostove dhe shpenzimeve të arsyeshme të bëra nga klienti për ta bërë atë.

7.4. Në rast të shkeljes së pretenduar të të drejtave të pronësisë intelektuale, furnizuesi me shpenzimet e tij dhe sa më shpejt që është e mundur t'i modifikojë ose t'i zëvendësojë shërbimet cenuese ose ndonjë pjesë të tyre për të shmangur një shkelje të tillë (me kusht që çdo zëvendësim ose modifikim i tillë të jetë në pajtueshmëri me kontratën dhe të mos jetë me funksionalitet më të vogël se materiali që thuhet cenues), dhe klienti dëmshpërblen klientin kundër të gjitha procedurave, veprimeve, pretendimeve, kërkesave, kostove, shpenzimeve (duke përfshirë por jo e kufizuar në kostot dhe pagesat ligjore në baza të avokatit dhe klientit) humbjeve dhe dëmeve që rrjedhin nga ose të shkaktuara nga klienti për shkak të periudhës së ndryshimit ose zëvendësimit të tillë.

8. GARANCIA

Mospërmbushja

8.1 Në rast se shërbimet janë të ndashme ose të dorëzuara në disa këste, klienti sipas gjykimit të tij mund të vendosë për të aplikuar të drejtën e vet vetëm për sa i përket shërbimeve akoma të papërfunduara.

8.2 Furnizuesi nuk ka të drejtë të kërkesës për dëmshpërblim të dëmit në rast se klienti e anulon kontratën.

Defektet e shërbimeve të kryera

8.3 Furnizuesi garanton se shërbimet do të kryhen në mënyrën e rënë dakord në kontratë ose zakonisht të pritur në rrjedhën normale të biznesit dhe se shërbimet përbëjnë cilësinë/specifikimet e rëna dakord dhe se të tilla shërbime do të jenë - për më gjatë se (i) 90 ditë pas kryerjes së shërbimeve dhe (ii) afati i kontratës - pa defekte në material dhe mjeshtëri në përdorim normal dhe të jetë i përshtatshëm për përdorim të pajtuar ose qëllimin zakonisht të pritur në rrjedhën normale të biznesit. Periudha e garancisë zgjatet me një periudhë të tillë kohore, gjatë së cilës shërbimet me defekte nuk mund të përdoren nga klienti në përputhje me kontratën për shkak të ndonjë defekti.

8.4 Në rast se shërbimet kryhen, por jo në mënyrën e rënë dakord në kontratë ose zakonisht të pritur në rrjedhën normale të biznesit, ose mungon cilësia/specifikimet e pajtuara, klienti nuk është i detyruar ta paguaj çmimin e blerjes dhe ka të drejta të kërkojë në diskrecionin e tij të vetëm ose (i) kryerjen e shërbimeve në mënyrën e rënë dakord në kontratë ose zakonisht të pritur në rrjedhën normale të biznesit, ose (ii) një reduktim të arsyeshëm të çmimit të blerjes, ose (iii) - pas dhënies së një periudhe të arsyeshme grejs për kryerjen e shërbimeve në mënyrën e rënë dakord në kontratë ose zakonisht të pritur në rrjedhën normale të biznesit - anulimin e kontratës. Të gjitha shpenzimet në lidhje me dëmshpërblimin të parashikuara në këtë pikë 7.4 do të mbulojnë nga furnizuesi.

9. KLASAT E DEFEKTEVE DHE KKOHA E REAGIMIT

9.1 Pas Vendimit të pranimit përfundimtar, klasifikimi i ndonjë gabimi ose defekti përcaktohet nga klienti në kohën kur gabimi ose defekti i tillë i njoftohet furnizuesit, dhe furnizuesi do të përgjigjet në një raport të thirrur në përgjegjësi nga klienti në përputhje me afatet kohore të mëposhtme në varësi të nivelit të ashpërsisë së rënë dakord ndërmjet klientit dhe furnizuesit për përgjegjësinë.

Defekti i klasës 1 do të thotë gabim në mjedisin e prodhimit që pengon të gjithë ose një funksionalitet substancial i cili materialisht e prish biznesin e klientit ose në thelb të gjitha shërbimet nga funksionimi në përputhje me kontratën. Gabimi i tillë është edhe i ashpër edhe mision kritik. Furnizuesi pranon përmes telefonit ose emailit defektin e tillë brenda 1 ore dhe një plan veprimi brenda 4 orëve për zhvillimin e arnimit ose të tejkalimit të gabimit të tillë.

Defekti i klasës 2 do të thotë gabim në mjedisin e prodhimit, ku funksionaliteti kryesor i shërbimeve pengohet, por gabimi i tillë nuk e prish materialisht biznesin e klientit. Furnizuesi pranon përmes telefonit ose emailit defektin e tillë brenda 4 ore dhe një plan veprimi brenda 12 orëve për zhvillimin e arnimit ose të tejkalimit të gabimit të tillë.

Defekti i klasës 3 do të thotë gabim në mjedisin e prodhimit, ku një pjesë e shërbimeve pengohet, por gabimi i tillë nuk e prish materialisht biznesin e klientit. Furnizuesi pranon përmes telefonit ose emailit defektin e tillë brenda 4 ore dhe një plan veprimi brenda 24 orëve për zhvillimin e arnimit ose të tejkalimit të gabimit të tillë.

9.2 Furnizuesi e rregullon çdo defekt me shpenzimet e veta nëse defekt i tillë nuk shkaktohet nga gabimet operative të klientit. Në rastin e fundit, furnizuesi do t'ia ngarkojë shërbimet e tilla të rregullimit klientit në bazë të afateve të aplikueshme për vënie të çmimit.

9.3 Në rast se furnizuesi nuk është në gjendje ta rregullojë defektin brenda një periudhe të arsyeshme kohore, klienti ka të drejtë të kërkojë rregullim të defektit nga një burim tjetër ose një reduktim të arsyeshëm të çmimit të blerjes. Çdo kosto e tillë mbulohet nga furnizuesi. Kërkesat për dëmshpërblim të mundshëm të klientit mbesin të paprekura.

10. SHKËPUTJA E KONTRATËS

10.1 Klienti ka të drejtë ta anulojë kontratën: (a) në përputhje me pikën 2.4, 2.5 ose 7.4; (b) nëse furnizuesi është ose bëhet i paaftë për t'i paguar borxhet e tij në kohën e duhur, ose i pezullon ose kërcënon t'i pezullojë pagesat në lidhje me të gjitha borxhet e tij, ose merr ndonjë veprim të korporatës, ose hapa të tjera ose procedurat ligjore iniciohen, për likuidimin, ndërprerjen, shpërbërjen ose riorganizimin e tij; ose për të filluar falimentimin ose likuidimin e tij, ose vullnetar ose të detyrueshëm, ose një kërkesë paraqitet në një gjykatë përkatëse për të deklaruar ose paaftësinë e tij paguese (falimentimin), ose menaxhimi i jashtëm apo menaxhimi i falimentimit miratohet në lidhje me këtë, ose deklarohet i falimentuar ose shkon në likuidim; (c) në qoftë se për arsye të tjera furnizuesi nuk mund të pritët që t'i përmbushë detyrimet e tij në lidhje me kontratën; (d) në qoftë se respektimi i kontratës do të shkaktonte vështirësi të panevojshme për klientin për shkak të arsyes së rëndësishme të ndodhur pas miratimit të kontratës.

10.2 Kërkesat për dëmshpërblim të mundshëm të klientit mbasin të paprekura nga anulimi i tillë.

11. DËMSPËRBLIMI

11.1 Furnizuesi e dëmshpërblen dhe e ruan nga dëmtimi Bankën, drejtorët, zyrtarët, punonjësit, nëpunësit dhe agjentët e vet, nga dhe kundër çdo dhe të gjitha humbjeve, pretendimeve, kërkesave, dëmeve, veprimeve, shkaqeve të veprimeve, kostove dhe shpenzimeve (duke përfshirë shpenzimet ligjore). Banka mund të përballojë ose të pësojë, që paraqiten direkt ose indirekt për shkak të: (a) ndonjë shkelje të kësaj marrëveshjeje nga **furnizuesi**, ose ndonjë agjent, punonjës, drejtor, zyrtar ose nën-marrëveshje të **furnizuesit**; (b) veprimeve ose mosveprimeve të **furnizuesit**, ose ndonjë agjenti, punonjësi, drejtori, zyrtari ose nën-marrëveshje nga **furnizuesi** përfshirë çdo lëndim ose vdekje të ndonjë personi ose çdo dëmtim të ndonjë personi dhe të gjithë personave ose pronës, qoftë i qëllimshëm, aksidental ose nga pakujdesia. Ky dëmshpërblim do ta mbijetojë ndërprerjen e marrëveshjes.

12. PËRFAQËSUESIT E FURNIZIMEVE

12.1 Furnizuesi garanton dhe i paraqet Bankës se furnizuesi ose ndonjëri nga nën-kontraktorët, agjentët ose nëpunësit e tij nuk i kanë ofruar ose rënë dakord për t'i dhënë ndonjë anëtar, punonjësi ose përfaqësuesi të Bankës ose ndonjë pale të tretë ndonjë dhuratë ose pagesë, konsideratë të çfarëdo lloji si nxitje ose si shpërblim për të bërë ose për të mos bërë ose për të hequr dorë nga ndonjë akt në lidhje me marrjen ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, ose për të treguar ose për të qenë në favor ose disfavor të ndonjë personi në lidhje me këtë marrëveshjeje.

Çdo praktikë e tillë do të jetë bazë për ndërprerjen e kësaj marrëveshjeje me efekt të menjëhershëm dhe/ose për të ndërmarrë ndonjë veprim tjetër korigjues sipas nevojës (duke përfshirë padi civile ose penale).

Paragrafi paraprak zbatohet edhe për çdo ndryshim, shtojcë ose amendamente të marrëveshjes.

13. KONFIDENCIALITETI

13.1 Marrëveshja për mosshpalosje e RBKO-së ose marrëveshja e konfidencialitetit e RBKO-së e lidhur ndërmjet furnitorit dhe klientit do të jetë pjesë e pandashme e kontratës dhe dispozitat përkatëse do të përfshihen në këto TKP mutatis mutandis. Raiffeisen Bank Kosova i përpunon të dhënat personale të personave fizikë në përputhje me Ligjin Nr. 06 / L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR)2016/679

13.2 Furnitori jep pëlqimin e tij të qartë për RBKO-në që të dhënat personale të ofruara ose çdo e dhënë që mund të jetë në dispozicion më vonë mund të përpunohen ose ruhen me qëllim të realizimit të kontratës në të cilën furnitori është palë ose me qëllim të ndërmarrjes së hapave me kërkesën e të dyja palëve para lidhjes së kontratës, vlerësimin e ofertës së tenderit dhe çfarëdo qëllimi tjetër legjitim brenda kufijve të ligjit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave.

13.3 Përveç kësaj, furnitori i garanton RBKO-së që e ka marrë tërë pëlqimin e nevojshëm të punonjësve të tij, anëtarëve të bordit menaxhues, të bordit mbikëqyrës, të pronarëve dhe të pronarëve përfitues për të shpalosur të dhënat e tyre personale ose çfarëdo të dhëne tjetër RBKO-së me qëllim të realizimit të kontratës në të cilën furnitori është palë ose me qëllim të ndërmarrjes së hapave me kërkesën e të dyja palëve para lidhjes së kontratës, vlerësimin të ofertës së tenderit dhe çfarëdo qëllimi tjetër legjitim brenda kufijve të ligjit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave.

13.4 Furnitori pajtohet dhe e autorizon bankën që të dhënat personale të ofruara dhe çfarëdo e dhënë tjetër që mund të jetë e disponueshme më vonë mund të përdoren dhe shkëmbehen ndërmjet anëtarëve të Raiffiesen Bank Kosovë dhe partnerëve të saj brenda dhe jashtë vendit, Bankës Qendrore të Kosovës dhe subjekteve dhe institucioneve të autorizuara me ligjin në fuqi për mbledhjen dhe pranimin e të dhënave të tilla.

14. LIGJI DREJTUES DHE JURDIKSIONI

14.1 Kontrata dhe çfarëdo detyrimi jo-kontraktual që dalin nga ose në lidhje me të administrohen me ligjet e Kosovës pa iu referuar konfliktit me ligjet, rregullat.

14.2 Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me kontratën, zgjidhet përfundimisht nga gjykatat kompetente të Kosovës.

15. TË NDRYSHME

15.1 Kontrata mund të ekzekutohet nga furnizuesi dhe klienti në çfarëdo numri të palëve homologe, secila prej të cilave përbën një origjinal.

15.2 Marrëveshja e mos-zbulimit të informatave të RBKO-së ose Marrëveshja e konfidencialitetit e RBKO-së e lidhur ndërmjet furnizuesit dhe klientit duhet të jenë pjesë e pandashme e kontratës, dhe dispozitat përkatëse përfshihen në këto AKP-ë mutatis mutandis. Përveç kësaj, furnizuesi jep pëlqimin e tij të qartë se çdo e dhënë nga furnizuesi ose në lidhje me atë mund të ruhen ose të përpunohet në formë elektronike dhe/ose të përdoret nga klienti në sistemin elektronik të përpunimit të të dhënave të RBI-së së Grupit brenda limiteve të Ligjit në fuqi për Mbrojtjen e të dhënave.

15.3 Furnizuesi ka marrë parasysh Kodin e Sjelljes së Raiffeisen Bank International për Furnizuesit ("KIS") dhe pajtohet se klienti gjatë lidhjes së kontratës ose zbatimit të saj ka të drejtë t'i japë përparësi në KIS. Megjithatë, furnizuesi nuk ka të drejtë të mbështetet në, e as të nxjerrë ndonjë të drejtë nga KIS. KIS mund të qaset permes linkut:

https://www.raiffeisen-kosovo.com/Uploads/Richtext/Files/Group%20CoC_AL.pdf

15.4 Furnizuesi nuk transfero të drejtat dhe detyrimet e tij në lidhje me kontratën pa pëlqimin paraprak me shkrim të klientit.

15.5 Furnizuesi pranon përgjegjësinë e plotë dhe të përgjithshme për pagesën e të gjitha tarifave, tatimeve, detyrimeve dhe ngarkesave të tjera, duke përfshirë TVSH-në, që janë kërkuar ose mund të kërkoen nga autoritetet qeveritare ose administrative ose tatimore në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi në Kosovë.

15.6 Nëse shërbimet e kryera nga ana e furnizuesit, përfshirë të drejtën pronësore dhe/ose licencat, tatimi në burim për të drejtën e pronësisë në përputhje me ligjet në fuqi në Kosovë, zbatohen dhe mbahen nga Banka dhe transferohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës. Me kërkesë të furnizuesit Banka ofron një vërtetim për mbajtjen në burim të tatimit.

15.7 Në rast se furnizuesi është konsorcium ose ndërmarrje tjetër kontraktuale e përbashkët, partneri udhëheqës është përgjegjës ndaj klientit për të gjitha përgjegjësitë në lidhje me zbatimin dhe ekzekutimin e kontratës, duke përfshirë, por jo e kufizuar në përmbushjen e përgjegjësive dhe detyrimeve të parashikuara në kontratë, pagesat e tatimeve dhe detyrimeve, pagesën e kompensimit dhe dëmshpërblimit ndaj klientit etj., pavarësisht nga ndonjë dispozitë në kundërshtim me marrëveshjen e konsorciumit ose ndonjë marrëveshje ose aranzhim tjetër ndërmjet partnerëve. Çdo komunikim zyrtar për ekzekutimin e kontratës bëhet nga ana e klientit për partnerin udhëheqës dhe përmes tij.

15.8 Nëse ndonjë dispozitë e kontratës është pjesërisht ose tërësisht e pavlefshme ose bëhet e tillë, kushtet e mbetura do të vazhdojnë të zbatohen. Dispozita e pavlefshme ose pjesa e pavlefshme e dispozitës konsiderohet për zëvendësim me një dispozitë ligjërish të vlefshme, e cila vjen sa më pranë të jetë e mundur me kuptimin komercial dhe qëllimin e dispozitës së pavlefshme ose pjesën e pavlefshme të dispozitës. Ky parim zbatohet mutatis mutandis në rast të ndonjë mangësie kontraktuale.

15.9 Përveç nëse klienti pajtohet me shkrim, zbatohet çdo afat dhe kusht i përgjithshëm i furnizuesit. Në rast se klienti është pajtuar me shkrim se afatet dhe kushtet e përgjithshme të furnizuesit bëhen të zbatueshme, dispozitat e këtyre AKP-ve dhe kontrata mbizotërojnë.

15.10 Furnizuesi duhet të jetë në përputhje me të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret në fuqi dhe e dëmshpërblen klientin për çdo shkelje të tillë.

15.11 Banka rezervon të drejtën që në çdo kohë, duke përfshirë por jo e kufizuar në, gjatë afatit të kësaj marrëveshjeje të hyjë në çfarëdo marrëveshje ose aranzhim me ndonjë subjekt ose subjekte të tjera për ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë edhe ato të përshkruara më sipër.

15.12 Asgjë në këtë marrëveshje ose kudo tjetër, nuk e detyron Bankën të blejë ndonjë shërbim, ose të garantojë blerje minimale të shërbimeve.

15.13 Klienti nuk është përgjegjës ndaj furnizuesit për ndonjë dëm nëse dëmet e tilla nuk shkaktohen nga pakujdesia e rëndë ose lajthitja e qëllimshme e klientit dhe pretendimet e dëmeve të tilla kufizohen në humbje të drejtpërdrejtë financiare të furnizuesit. Në asnjë mënyrë klienti nuk është përgjegjës për ndonjë dëm të tërthortë ose rrjedhimor, humbje të prodhimit, humbje të fitimit, etj.

16 OFRIMI I SHËRBIMEVE

16.1 Furnitori do t'i ofrojë Shërbimet e porositura nga Klienti në përputhje me këtë Marrëveshjen, por jo më vonë se data e dërgimit të specifikuar në Marrëveshje. Furnitori Ofruesi duhet ta njoftojë Klientin dhe të marrë miratimin paraprak me shkrim në lidhje me çdo shtyerje të afatit të kryerjes së shërbimeve.

16.2 Sa i përket vonesave në kushtet e dakorduara të kryerjes së Shërbimeve, Klienti rezervon të drejtën për të ngarkuar tarifën e dënimit në shumë prej 3% të faturës mujore, për secilën ditë të vonesës deri në datën e kryerjes së Shërbimeve.

16.3 Në rast se vonesa tejkalon 3 (tri) ditë kalendarike, Klienti ka të drejtë ta ndërpresë këtë marrëveshje me efekt të menjëhershëm. Furnitori është i detyruar të paguajë 30% (tridhjetë) të shumës së dakorduar të marrëveshjes. Në një rast të tillë, Furnitori nuk ka të drejtë të kërkojë kompensime për dëme.

16.4 E drejta e Klientit për të kërkuar kompensime shtesë për dëme mbetet e paprekur nga gjopa kontraktuale dhe në veçanti përfshin, por pa u kufizuar në, të gjitha kostot e shkaktuara nga Furnitori për blerjen e Shërbimeve zëvendësuese nga një tjetër Furnitor.